



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal 04/2018

Procesverbali i mbledhjes së Komitetit të Komuniteteve me datën 31.05.2018.

Rendi i ditës :

- 1-Konfirmimi i pjesëmarrjes së anëtarëvetë komitetit.
- 2-Diskutim rreth rekomandimit për meremetimin e rrugicave ku jetojnë komunitetet
- 3-Caktimi i një vizite pjesëtarëve të komunitetit pëe të parë gjendjen e tyre
- 4-Të ndryshme

Mbledhja filloi në ora 14:30 me praninë e të gjithë anëtarëvetë Komitetit për Komunitete.

Procesverbali u miratua pa asnjë verejtje.

Ne si komitet nga zyra komunale për Komunitete kemi marrë një evidencë të të gjitha rrugëve të lagjeve ku banojnë komunitetet dhe të cilat kanë nevojë të asfaltohen, të ketë rrjetë kanalizimi, disa rrugica të shtrohen me zhavorr. Për ta parë gjendjen ne si komitet në muajin qershor do të dalim në vizitë për të parë për së afërmi gjendjen aktuale të tyre ku do të ndahemi në grupe që të mund të përfshijne sa më shumë lagje ku këta pjesëtarë të komuniteteve jetojnë.

Hatixhe Bungu Qerimi- Pasi të dalim në terren dhe të shohim gjendjen faktike të rrugëve ne do të rekomandojmë rrugën e cila është më urgjente që të intervenohet në të, sepse këtu ka shumë rrugë dhe nuk mundemi që të gjitha përnjëherë t'i ju bëjmë zgjidhje. Gjithashtu do të marrim edhe informata për vështirsitë apo problemet me të cilat ballafaqohen këto komunitete, konsiderueshëm të fëmijëve të këtyre komuniteteve të cilat nuk vijnë mësimi.

Hesat Shatrolli- Kjo gjendje është në të vërtetë shqetësuese andaj ne do të mundohemi t'i bëjmë zgjidhje shumë nga këto rastë në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit.

Procesmbajtësja

Hatixhe Bungu Qerimi

Kryetari i Komitetit



Xhemajl Jashari